



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.276/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për Kuvend Komunal nga radha e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, Lulzim Gacaferri, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Junik, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 22.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR, ankesa e parashtruar nga kandidati për Kuvend Komunal nga radha e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, Lulzim Gacaferri, ZL.Anr.276/2025 e datës 20.10.2025, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Junik për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 20.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për Kuvend Komunal nga radha e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, Lulzim Gacaferri, të dërguar përmes postës më datë 16.10.2025, me të cilën pretendon se ka pranuar thirrje të shumta nga qytetarët të cilët e kanë votuar, megjithatë në vendvotimin nr.3101/04 sipas rezultatit të zgjedhjeve ka marrë vetëm 7 vota, që nga informacionet e marra nga qytetarët numri i votuesve që i kanë konfirmuar votën varion nga 28 deri në 30 persona vetëm në një vendvotim, përkatësisht në vendvotimin 3101/04. Tutje ka shtuar se vetëm familja e motrës së tij përbëhet nga 7 votues, ët cilët kanë konfirmuar se e kanë votuar, çka do të thotë se ky fakt e tejkalon numrin e votave që i janë regjistruar në rezultatet zyrtare. Tutje shton se ka pranuar shume deklarime të qytetarëve të tjerë që e kanë kontaktuar, krijohet një pasqyrë e qartë e një mospërputhjeve të theksuar ndërmjet vullnetit real të votuesve dhe rezultatit të numëruar, që ngre dyshime të arsyeshme se ka pasur gabim në procesin e numërimit të votave për subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje. Në ankesë pala pretendon se këto gjetje burojnë vetëm nga një vendvotim specifik, përkatësisht 3101/04, dhe se ekziston një probabilitet i lartë që të zbulohen situata të ngjashme edhe në vendvotime tjera brenda Junikut, dhe në mënyrë që të ruhet integriteti i procesit zgjedhor, të sigurohet transparencë dhe të garantohet që çdo votë të numërohet saktë dhe drejt, kërkoj nga PZAP që të miratoj këtë ankesë dhe të urdhërojë rinumërimin e votave

për subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje, në Junik, me fokus të veçantë vendvotimin 3101/04 dhe çdo vendvotim tjetër ku eventualisht mund të konstatohen mospërputhje të ngjashme.

Në përgjigjen në ankesë të datës 20.10.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kanë deklaruar, theksojnë se pretendimet e palës ankuese se procedura e numërimit të QKN përcaktohet me nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025. Rezultate preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për QKN, andaj bazuar në Rregulloren Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se në: në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV ose QV. Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimit me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesin pretendimet e saj të paraqitura në ankesë.

Tutje në përgjigje në ankesë kanë theksuar se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të ankesës që mbështetët në deklaratimet e personave, duhet theksuar se në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të LZP-së Nr. 08/L-228, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës për mospërputhje të rezultatit zgjedhor, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, gjatë shqyrtimit të ankesave është vërejtur se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova relevante që do të mund të dëshmonin apo mbështetësin pretendimet e mospërputhjes së rezultateve zgjedhore.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

- ankesa është e pabazuar

Në bazë të shkresave të lëndës, përgjigjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore të kandidatit Lulzim Gacaferri, *se ka marrë vetëm 7 vota, ndërsa nga informatat që ka marrë nga qytetarët, numri i votave varion nga 28 në 30 në një vendvotim, përkatësisht në vendvotimin 3101/04, dhe se ka pasur mospërputhje ndërmjet*

vullnetit të votuesve dhe rezultatit të numërimit, janë të pa bazuara për faktin se i njëjti nuk ka arritur që të vërtetoj, përkatësisht të dëshmoj faktin se ka pasur vota më shumë, përveq se thekson se ka pasur konfirmime nga disa persona se kinse e kanë votuar, ndërsa ankesës nuk i ka bashkangjitur prova konkrete dhe bindëse, dhe nuk ka arritur të argumentoj pretendimet e shprehura në ankesë. Kurse pretendimet e theksuara më shumë janë supozime se sa thënie të dokumentuara në fakte dhe në prova konkrete.

Pretendimet e palës ankuese, duke dërguar një listë me emra dhe mbiemra, se dëshmitarët mund të dëshmojnë për votën e tyre, nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar se ka ekzistuar shkelja e pretenduar.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga kandidati për Kuvend Komunal nga radha e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, Lulzim Gacaferri, është e pabazuar pasi që nuk ka bashkangjitur asnjë provë tjetër përkatësisht pretendimi se vetëm në vendvotimin 3101/04 numri i votave varion nga 28 deri në 30, mirëpo që sipas rezultatit të KQZ-së është 7, mbetën pretendime të pabazuara dhe se nuk është mbështetur me asnjë provë që do të dëshmonte pretendimet ankimore. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla mbeten vetëm në suazë të dyshimit dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosi së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
ZLAnr.276/2025 datë 22.10.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.